



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Komisioni Vlerësues** (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr.011/01-8158 të datës 30.03.2022, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe neni 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01 Nr.011/01-8186 të datës 30.03.2022, të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 15.09.2022 merr vendim për shpalljen e:

**NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK  
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË  
PALUJATSHME KOMUNALE - BYFETË**

Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit, personat fizik dhe juridik që të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes në shfrytëzim të pronës së palujatshme komunale:

**1. Pronat e palujatshme për dhënien në shfrytëzim gjenden:**

- Prona e evidentuar në parcelën me nr. P-70705029-01166-1 në sipërfaqe prej 26.00 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e SHME "Kadri Kusari" në Gjakovë;
- Prona e evidentuar në parcelën me nr. P-70705029-02130 në sipërfaqe prej 12.60 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e SHMU "Mazllum Këpuska" në Gjakovë;
- Prona e evidentuar në parcelën me nr. P-70705037-00293-1 në sipërfaqe prej 12.00 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e SHFMU "Selman Riza" në Gjakovë;
- Prona e evidentuar në parcelën me nr. P-70705029-00468-1 në sipërfaqe prej 40.49 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, në objektin e Gjinnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë;
- Prona e evidentuar në parcelën nr. P-70705029-00066-2-002130, në sipërfaqe prej 32.00 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet në objektin e SHFMU "Zekeria Rexha" në Gjakovë.

**2. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës:**

Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujatshme komunale do të jetë afatshkurtër, deri në pesë (5) vite.

## Qëllimi:

### **Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është:**

1. Funksionalizimi i Byfes për furnizim me produkte ushqimore në shkolla;
2. Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies.

## Kushtet e veçanta:

- a) Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të byfeve është:
  - SHME “Kadri Kusari” në Gjakovë në sipërfaqe prej 26.00 m<sup>2</sup>, në emër të qirasë mujore do të jetë 280,00€;
  - SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë, në sipërfaqe prej 12.60 m<sup>2</sup>, e evidentuar në në emër të qirasë mujore 200,00€;
  - SHFMU “Selman Riza” në Gjakovë, në sipërfaqe prej 12.00 m<sup>2</sup>, në emër të qirasë mujore 150,00€;
  - Gjimnazin “Hajdar Dushi” në Gjakovë në sipërfaqe prej 40.49 m<sup>2</sup>, në emër të qirasë mujore 700,00€;
  - SHFMU “Zekeria Rexha” në Gjakovë, në sipërfaqe prej 32.00 m<sup>2</sup>, në emër të qirasë mujore 350,00€.
- b) Përzgjidhet oferta me çmimin me të lartë të ofruar në ankand;
- c) Në rast se në ankand ofrohen dy apo me tepër çmime më të larta dhe të njëjtat, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertave, në praninë e tyre dhe të Komisionit Vlerësues.
- d) Në byfe ndalohet përdorimi/ shërbimi i pijeve alkoolike dhe duhanit.

## Kushtet e përgjithshme të ankandit publik:

1. Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale do të jetë afatshkurtër, deri në pesë (5) vite.
2. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. **Personat fizik** të cilët marrin pjesë në këtë procedurë, ofertës duhet bashkangjitur këto dokumentacione: **Fotokopja e dokumentit valid të identifikimit – letërnjoftimi dhe Vërtetimin e Tatimit në Pronë (që nuk ka detyrime të papaguara).** **Personat juridik** të cilët marrin pjesë në këtë procedurë, ofertës duhet bashkangjitur këto dokumentacione: **Certifikatën e regjistrimit të biznesit, Vërtetimin e ATK-së mbi kryerjen e obligimeve tatimore dhe Vërtetimin e tatimit në pronë (të pronarit të biznesit, që nuk ka detyrime të papaguara).**
3. Ofertuesit që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.

4. **Komisioni pas hapjes së ofertave, do të bëjë verifikimin e detyrimeve të papaguara të tatimit në pronë në zyrën përkatëse të Komunës së Gjakovës, si dhe obligimeve tjera ndaj Komunës. Nëse evidentohet që ofertuesi ka detyrime të papaguara do të diskualifikohet nga ankandi për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale.**
5. Shfrytëzimi i pronave mund të bëhet vetëm sipas destinimit të cilin e kanë - byfe.
6. Komuna për interes të përgjithshëm në zbatim të projekteve në prona publike rezervon të drejtën të realizoj punime pa u penguar nga shfrytëzuesi.
7. Shpenzimet e ujit, rrymës, mbeturinave dhe ngrohjes janë të kalkuluara brenda çmimit fillestar.
8. Taksat komunale dhe shërbimet tjera do të mbulohen nga shfrytëzuesi.
9. Ofertuesit nuk mund të paraqesin më shumë se një ofertë për marrjen në shfrytëzim të byfeve në këtë njoftim publik.
10. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb – faqe të Komunës dhe në vendet publike. **Ofertat** me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen të mbyllura (në pliko) në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimet, kati përdhësë, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë, nga data **16.09.2022** deri me datë **30.09.2022** në orën 15:00h dhe të protokollohen nga Komuna.
11. **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** Objekti i Komunës së Gjakovës, Rruga “UÇK” (ish objekti i Bankosit), kati IV, salla e asamblesë komunale, me datë **04.10.2022** nga ora 10:00 h. Fillimisht bëhet hapja e ofertave të mbyllura në formë publike, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.
12. **Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:** Të informohen me procedurat e ankandit publik, të shohin pronën që jepet në shfrytëzim, të kenë qasje në dokumentacionet e pronës dhe të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
13. Procedurat e ankandit mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.

- 14. Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** Komisioni Vlerësues brenda tre (3) ditësh pune pas mbylljes së njoftimit publik, fton për hapjen e ankandit dhe vlerësimin e ofertave. Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bën hapjen e ofertave ku identifikohen të gjitha çmimet e ofertuesve. Pas vlerësimit të ofertave në ankand publik, Komisioni vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën fituese. Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues, njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike si dhe në web-faqen zyrtare të komunës.
- 15.** Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtroj ankesë pranë “Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës.
- 16.** Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, pas rekomandimit nga komisioni.



**Kosovar Alija**

**Kryesuesi i Komisionit Vlerësues**